



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 20.06.2025

Numër Protokolli: 4237/2025

A.nr.853/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.853/2025, të datës 07.05.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.853/2025, e datës 07.05.2025, e parashtruar nga ankuesi B.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, B.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), kandidat për pranim në pozitën e punës *Drejtore i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit*, të shpallur me datë 14.03.2025, sipas Konkursit me numër Reference RN00017027, nga Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 07.05.2025 ka parashtruar ankesë në e-mailin zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net, e cila ankesë është regjistruar me datë 06.05.2025 dhe protokolluar me numër 3012/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 29.04.2025, lidhur me refuzimin e aplikacioni të punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa ***është e parakohshme***, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 19.03.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017027, për pozitën e punës të kategorisë së lartë drejtuese “*Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit*”, me afat aplikimi nga data 15.03.2025 deri më datë 13.04.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo sipas Njoftimit të datës 29.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, rezulton se të njëjtit i është refuzuar aplikacioni i punësimit, me arsyetimin se nuk posedon arsimimin përkatës sipas shpalljes së konkursit.

Ankuesi, kundër Njoftimit të lartë theksuar, lidhur me refuzimin e aplikacionit të punësimit, ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimin ankimor se ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit përkatës, andaj kërkon anulimin e vendimit kontestues për përjashtimin e tij nga procedura e rekrutimit dhe rikthimin e të njëjtit në fazat e mëtejshme të përzgjedhjes.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht nenit 47 paragrafi 10 ku përcaktohet se: *10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.* si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi më datë 07.05.2025, kundër Njoftimit të datës 29.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me refuzimin e aplikacionit, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati i pakënaqur ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesi ka dorëzuar ankesën ende pa u publikuar rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017027, për pozitën e punës “*Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit*”.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e dorëzuar nga ankuesi me datë 07.05.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.853/2025, të datës 07.05.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.853/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.K;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.